

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Organizatat kosovare i kërkojnë Amnesty International të përfshijë krimet serbe në deklaratën për Hagën
ADRESA	https://albeu.com/kosove/organizatat-kosovare-i-kerkojne-amnesty-international-te-perfshije-krimet-serbe-ne-deklaraten-per-hagen/1027370/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHË


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 14:38:46 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 14:36:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9efa43f7351a536cc7da5017810973ea21c9408f5ce41521e5d90337be3ecef2
TEKSTI	d8bc4502b2039f71f90d25ed8db7e9f86c0930107930345b6de22bb24f90505a
PAMJA	f73d920c8ff40c203661f3ef4892835600b21b6ea95ebd0f4a483f95fc0d8ccb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0a3e71a642a17777146e470e2736eef5d9f81cfcd8782368602eb9fe7c74a4e2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a8b637500bb34dd44849ee47713c862e0f86b2067940dc4d517e848dfddb5dc3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0a3e71a642a17777146e470e2736eef5d9f81cfcd8782368602eb9fe7c74a4e2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Organizatat kosovare i kërkojnë Amnesty International të përfshijë krimet serbe në deklaratën për Hagën



Një grup organizatash të shoqërisë civile në Kosovë i kanë dërguar një letër Amnesty International, përmes së cilës kërkojnë rishikimin dhe sqarimin e deklaratës së publikuar për aktgjykimin e shkallës së parë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Sipas tyre, deklarata e datës 16 shtator 2026 nuk e paraqet në mënyrë të plotë kontekstin e viktimave të luftës në Kosovë, pasi nuk përmend krimet e kryera nga forcat serbe dhe nevojën për përgjegjësi për këto vepra.

Në letrën e tyre, organizatat theksojnë se Amnesty International duhet të japë informacion të mjaftueshëm në mënyrë që edhe personat që nuk e njohin historinë e konfliktit në Kosovë ta kuptojnë saktë atë që ka ndodhur.

Shqetësimi kryesor lidhet me pjesën e deklaratës ku thuhet se dënimet "u japin shpresë mijëra viktimave të luftës në Kosovë", ndërsa pjesa tjetër e tekstit përqendrohet kryesisht te procedurat gjyqësore ndaj katër të akuzuarve.

Organizatat vlerësojnë se, ndonëse deklarata u referohet vuajtjeve të viktimave të luftës në përgjithësi, ajo nuk ofron asnjë të dhënë për krimet e kryera nga forcat serbe. Për këtë arsye, sipas tyre, krijohet një pasqyrë e paplotë e historisë së konfliktit.

Ato sqarojnë se e kuptojnë mundësinë që një vendim gjyqësor t'u japë shpresë viktimave që presin drejtësi në raste të tjera. Megjithatë, kërkojnë që të bëhet dallim i qartë mes kësaj shprese së përgjithshme dhe përgjegjësisë konkrete të shqyrtuar në procesin gjyqësor ndaj Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit.

Sipas tyre, pa një ndarje të tillë, lexuesit që nuk kanë njohuri për konfliktin mund të krijojnë përshtypjen se të gjitha viktimat e luftës në Kosovë lidhen me krimet e trajtuara në këtë aktgjykim të veçantë.


të fundit /



PD propozon ndarjen e re territoriale: 100 bashki dhe 12 qarqe



Oltjon Muzaka largohet nga Shëndetësia dhe emërohet zv.ministër ...



Hëna e Korries dhe Saturni do të ndriçojnë qiellin në një shfaqje t...



Rashica: Kosova kërkon fitoren e radhës ndaj Austrisë pas...



Sistemi "Safe City" shtrihet në Ohër, Kërçovë, Strugë dhe...



Çlirim Haziri fton qytetarët të vendosin flamujt e UÇK-së në...



Shtëpia e Bardhë kufizon mbulimin mediatik të mbërritjes...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Organizatat argumentojnë se as sniirat e veprave penale të përsnira në pjesën e shtatë nuk e zgjidhin këtë problem. Ato, sipas letrës, tregojnë vetëm përmasat e çështjes gjyqësore, por nuk shpjegojnë viktimizimin më të gjerë gjatë luftës dhe nuk bëjnë dallimin mes autorëve të ndryshëm.

Edhe përmendja e lirimeve nga akuzat për krime kundër njerëzimit dhe e mundësisë së apelimit, ndonëse konsiderohet e nevojshme, lidhet me rezultatin procedural dhe jo me mungesën e kontekstit historik, thuhet në letër.

Sipas databazës Kosovo Memory Book, të përpiluar bashkërisht nga Humanitarian Laë Center dhe Humanitarian Laë Center Kosovo, deri më 7 nëntor 2014 ishin regjistruar gjithsej 13,517 persona të vrarë ose të zhdukur në lidhje me luftën në Kosovë gjatë periudhës 1 janar 1998 – 31 dhjetor 2000.

Nga kjo shifër, 10,792 ishin shqiptarë, 2,197 serbë, ndërsa 528 persona i përkisnin komuniteteve romë, boshnjake dhe komuniteteve të tjera. Të dhënat përfshijnë civilë dhe pjesëtarë të forcave të armatosura.

Organizatat nënvizojnë se këto shifra dokumentojnë humbjet gjatë konfliktit dhe periudhës pas tij, por nuk përcaktojnë përgjegjësi që mund t'u atribuohet katër të pandehurve. Po ashtu, ato nuk pasqyrojnë të gjitha dëmet e pësuar nga të mbijetuarit.

Veç kësaj, bazuar në të dhënat e mbledhura nga të njëjtat organizata, forcat serbe vranë 6,872 civilë shqiptarë në Kosovë ndërmjet 20 marsit dhe 14 qershorit 1999.

Sipas letrës, kjo shkallë e dokumentuar e vrasjeve të civilëve është pjesë thelbësore e kontekstit kur flitet për numrin e përgjithshëm të viktimave të luftës në Kosovë dhe për kërkesat e tyre të vazhdueshme për drejtësi.

Organizatat theksojnë gjithashtu se, njëzet e shtatë vjet më vonë, asnjë komandant i lartë i VJ-së apo MUP-it nuk është ndjekur penalisht në Serbi për operacionet gjatë të cilave u vranë mijëra civilë.

Kjo, sipas tyre, ndodh pavarësisht mijëra fakteve të përcaktuara në aktgjykimet e ICTY-së për veprimet e njësive të VJ-së dhe MUP-it, si dhe lidhjet e këtyre njësive me strukturat komanduese të drejtuara nga gjeneralë të cilët përfundimisht u dënuan.

Nënshkruesit pranojnë se një deklaratë për një aktgjykim individual nuk mund të përshkruajë të gjithë historinë e luftës. Megjithatë, kur Amnesty International i referohet popullsisë së gjerë të viktimave të luftës në Kosovë, ajo duhet të ofrojë kontekst të mjaftueshëm për ta paraqitur këtë histori në mënyrë të përgjegjshme.

Sipas tyre, mungesa e çdo reference ndaj krimeve të forcave serbe lë jashtë përvojat e viktimave të këtyre krimeve, edhe pse deklarata mbështetet në vuajtjet e viktimave të Kosovës në tërësi.

Organizatat kërkojnë që përgjegjësia të lidhet gjithmonë me autorët, veprat dhe gjetjet konkrete të një procesi gjyqësor. Ato vlerësojnë se historia e përgjithshme e konfliktit nuk duhet të përcillet përmes vetëm një procesi, ndërsa drejtësia për viktimat që nuk janë pjesë e këtij gjykimi duhet të mbetet e dukshme.

Për këtë arsye, Amnesty International i kërkohet ta ndryshojë deklaratën, duke bërë të qartë dallimin mes viktimave të përfshira në çështjen Thaçi et al. dhe popullsisë së përgjithshme të viktimave të luftës në Kosovë.

Gjithashtu, organizatat kërkojnë që në deklaratë të shtohet një kontekst i shkurtër për krimet e kryera nga forcat serbe dhe për nevojën e vazhdueshme që autorët e këtyre krimeve të mbajnë përgjegjësi. Nëse përmendja e mijëra viktimave synon të shprehë shpresën më të gjerë që mund të sjellë përgjegjësia penale, kjo duhet të thuhet qartë.

"Kërkesa jonë buron nga përkushtimi ndaj së vërtetës, drejtësisë dhe reparacionit për të gjitha viktimat, pavarësisht përkatësisë etnike apo identitetit të personave përgjegjës. Ne mbështesim procese të drejta gjyqësore, respektimin e së drejtës së apelimit dhe komunikimin publik që paraqet me saktësi si gjetjet gjyqësore, ashtu edhe kontekstin historik në të cilin ato janë dhënë", thuhet në letër.

Organizatat kërkojnë gjithashtu një përgjigje me shkrim nga Amnesty International, ku të shpjegohet se si do t'i trajtojë këto shqetësime.

Letra është nënshkruar nga Prishtina Institute for Political Studies (PIPS), Kosovo Law Institute (KLI), Council for the Defence of Human Rights and Freedoms (CDHRF), Kosova Democratic Institute / Transparency International Kosova, Kosovo Advocacy and Development Centre (KADC), FOL Movement, Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion (QIKA), The Kosovar Organization for Talent and Education (TOKA), Schüler Helfen Leben Kosova, Fourth Wave, Ramadan Ilazi – Head of Research at Kosovo Centre for Security Studies (KCSS), Network of NGOs AVONET dhe YES NGO.



Çlirim Haziri fton qytetarët të vendosin flamujt e UÇK-së në shtëpitë e tyre



Rukiqi kërkon sqarime për importin e produkteve braziliane: Pse Kosova n...



I kërkohet Avokatit të Popullit ta dërgojë Ligjin për Specialen në Kushtetuese



Gërvalla: Projektligji për Byronë i është dërguar Zyrës së Kryeministrit



Nagavci: Kanë mbetur 11 ditë për zgjedhjen e presidentit, nevojitet qasj...



Haxhiu: Familjarët e Thaçit, Veselit dhe Krasniqit nuk e pranuan ftesën për takim



Von der Leyen të enjten viziton Prishtinën



Kurti paralajmëron zgjedhje të reja në rast të moszgjedhjes së presidentit



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko...

Kërko

Kryesore

Erion Vellaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.